



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

Bashkia Shkodër

2017

Ky raport është hartuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH) dhe Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (RrFGSh), në kuadrin e projektit “Ndërtimi i kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të lidhura me reduktimin e dhunës në baza gjinore dhe dhunës në familje të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020”. Projekti zbatohet nga QAGJZH dhe RrFGSh në kuadër të programit rajonal kundër dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi ‘Zbatojmë Standartet, Ndryshojmë Mendësitë’, të zbatuar nga UN Women me mbështetjen financiare të Komisionit Evropian. Programi synon krijimin e një mjedisi legjislativ dhe politik të përshtatshëm për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, për të mundësuar ulje të fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri.

Përmbajtja e këtij manuali është vetëm përgjegjësi e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, dhe nuk reflekton opinionin e Komisionit Evropian dhe UN Women.

Autorët

Mirela Arqimandriti

Atila Uligaj

Megi Llubani

Tabela e përmbajtjes

SHKURTIME	4
HYRJE	5
METODOLOGJIA	7
TË DHËNA TË PËRGJITHSHME	9
INFORMACIONI MË POSHTË I REFEROHET GJETJEVE TË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË GJATË VITIT 2017. RAPORTI DO TË PASUROHET MË TEJ ME GJETJET RAPORTIMEVE PER VITET 2018 DHE 2019.	12
MONITORIMI I QËLLIMIT TË III-TË STRATEGJIK TË STRATEGJISË KOMBËTARE DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2016-2020	12
GJETJET KRYESORE.....	12
TË DHËNA STATISTIKORE	14
REZULTATET E MONITORIMIT – VITI 2017	15
OBJEKTIVI 3.1: NDËRGJEGJËSIMI I SHOQËRISË PËR TË MOS PRANUAR DHE PËR TË MOS TOLERUAR USHTRIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.	15
OBJEKTIVI 3.2: FUQIZIMI I MEKANIZMAVE TË REFERIMIT SI DHE SHTIMI/PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË SPECIALIZUARA PËR MBROJTJEN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.....	20
OBJEKTIVI 3.3: NDËSHKIMI I DHUNUESVE DHE DHËNIA E MUNDËSISË PËR REHABILITIMIN E TYRE, PËRMES PRORAMEVE TË SPECIALIZUARA.	25
REKOMANDIME NË BAZË TË MONITORIMIT TË PUNËS KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE NË BASHKINË SHKODËR	27
ANEKSE	29
ANEKSI 1- DETYRAT E KOORDINATORIT PËR BARAZI GJINORE DHE KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE.....	29
ANEKSI 2- DETYRAT E TË GJITËH ANËTARËVE QË KANË NËSHKRUAR MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIMIT SI PJESTARË TË MEKANIZMIT TË RREFERIMIT KUNDËRDHUËS ME BAZË GJINORE	31
ANEKSI 3 – INFORMACIONI SHITESË	31

Lista e tabelave

Tabela 1: Profili i Bashkisë Shkodër.....	9
Tabela 2: Të dhëna demografike mbi popullsinë e Shkodrës.....	10
Tabela 3. Raportimet e dhunës me bazë gjinore në stacionet e policisë së Bashkisë Shkodër	15
Tabela 5. Tabela e aktiviteteve të zhvilluar në bashkinë e Shkodrës kundër dhunës në familje ..	17
Tabela 6. Numri i mbledhjeve të GTN-së sipas viteve	23
Tabela 7. Numri i mbledhjeve të KD-së sipas viteve	23
Tabela 8. Koordinatorit vendor kundër dhunës me bazë gjinore.....	24
Tabela 9. Përfaqësuesit e GTN-së së bashkisë Shkodër.....	24
Tabela 10. Tabela e referimeve të dhunuesve	26
Tabela 11. Dhunuesit në sistemin gjyqësor Shkodër	27

Shkurtime

ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
BGj	Barazia Gjinore
DhBGj	Dhunë me bazë Gjinore
DhF	Dhunë në Familje
DhKG	Dhunë ndaj Grave
GTN	Grupi Teknik Ndërdisciplinor
INSTAT	Instituti i Statistikave në Shqipëri
IZhA	Instituti i Zhvillimit të Arsimit
KONVENTA CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KONVENTA E STAMBOLLIT	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
KD	Komiteti Drejtues
MD	Ministria e Drejtësisë
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MRR	Mekanizmi i Referimit të Rasteve
(MMSR)MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NBGj	Nëpunës i Barazisë Gjinore
NjVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OJF	Organizatë Joqeveritare (Jo-fitimprurëse)
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
PShSh	Policia e Shtetit Shqiptar
QAGjZh	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
QZhK “Sot për të Ardhmen”	Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”
REVALB	Sistemi elektronik (on-line) i regjistrimit të rasteve të dhunës në Shqipëri
RrFGSh	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
SKBGj	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
ShGPS	Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës
UM	Urdhër Mbrojtjeje
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UN WOMEN	Entitet i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Hyrje

Projekti “Ndërtimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile (OShC-ve) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020” në lidhje me reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje gjatë periudhës Nëntor 2017 – Tetor 2019. Në Shqipëri projekti zbatohet nga QAGjZh dhe RrFGSh në kuadër të programit rajonal kunder dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi ‘Zbatojmë Standartet, Ndryshojmë Mendësitë”, të zbatuar nga UN Women me mbështetjen financiare të Komisionit Evropian. Njësitë administrative të përfshira në monitorim janë bashkitë e Tiranës, Korçës, Shkodrës, Vlorës, Elbasanit, Durrësit. Njëkohësisht, po në kuadër të zbatimit të Objektivit të 3-të të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020, monitorimi ndërmerret edhe për aktivitetet e planifikuara në nivel kombëtar.

Qëllimi i projektit është krijimi i një mjedisi legjislativ dhe politik të përshtatshëm për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, ndërsa rezultati i pritur në terma afatgjatë është ulja e fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri. Procesi monitorues i SKBGj dhe PKV 2010-2020 është duke u zhvilluar përgjatë periudhës Mars 2018 - Shtator 2019. Aktivitetet në nivel qendror do të monitorohen nga QAGjZh dhe RrFGSh përmes mbledhjes së të dhënave zyrtare lidhur me zbatimin e aktiviteteve të PVK 2016-2020 nga të gjitha institucionet përgjegjëse, ndërsa aktivitetet në nivel vendor do të monitorohen nga organizatat lokale, disa prej tyre anëtare të RrFGSh.

Arritjet e pritshme: 1) OShC-të kanë kapacitetet e nevojshme për të monitoruar zbatimin e Objektivit të 3-të të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020; 2) Procesi i monitorimit nga OShC-të përfundohet me sukses për vitin 2018 dhe 2019; 3) Realizimi i procesit të advokimit nga OShC-të, për zbatimin e objektivit të 3-të të SKBGj 2016-2020, duke përdorur gjetjet dhe rekomandimet e proceseve monitoruese.

Ky projekt, e ka nisur punën me organizimin e seancave informuese me OShC-të në 6 bashkitë e synuara, duke vijuar më pas me zhvillimin e një manuali/udhëzuesi për monitorimin e Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, për përdorim gjatë trajnimeve me OShC-të lokale që do të monitorojnë Qëllimin Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020. Përveç manualit u hartuan disa skeda monitoruese të cilat u ndërtuan bazuar në indikatorët për monitorimin e zbatimit të Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020. Procesi i monitorimit të Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020 është duke u realizuar në të gjashtë bashkitë, si dhe në nivel qendror, për 2 vite me radhë (2018 dhe 2019). Pjesë e procesit monitorues janë edhe aktivitetet e planit të veprimit të zbatuara gjatë vitit 2017. Të dhënat e mbledhura nga monitoruesit do të analizohen dhe në bazë të kësaj analize do të hartohen raportet (2018, 2019) me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Pas publikimit të raporteve, do të organizohen tryeza të rrumbullakëta në çdo qark lidhur me gjetjet e procesit monitorues, pasuar nga takime advokuese me instancat vendimmarrëse e politikëbërëse. Paralelisht, do të bashkëpunohet me profesionistë të medias për të raportuar periodikisht gjetjet dhe rekomandimet e dala përfshirë informimin në mediat sociale, por edhe për të ngritur kapacitetet e tyre rreth raportimit të ndjeshëm gjinor.

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2017. Raporti do të pasurohet më tej me gjetjet e raportimeve për vitet 2018 dhe 2019.

Rreth organizatave zbatuese

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGjZh) është një organizatë jo-fitimprurëse shqiptare që vepron dhe punon në të gjithë Shqipërinë për fuqizimin e grave dhe për të krijuar një të ardhme të barabartë dhe të drejtë për vajzat dhe gratë me të ardhura të ulëta në të gjithë Shqipërinë, duke u përpjekur për t'i nxjerrë nga varfëria dhe përjashtimi. Për të mbrojtur të drejtat e grave dhe për t'i fuqizuar ato, QAGjZh ngre fonde kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fushat kryesore të ekspertizës së QAGjZh-së janë:

- Promovimi i paqes dhe përpjekjet për ti dhënë fund dhunës me bazë gjinore;
- Garantimi i fuqizimit ekonomik të grave;
- Sipërmarrjet e grave;
- Fuqizimi i qytetarëve për të monitoruar axhendën gjinore lokale;
- Rritja e përfaqësimit të grave në politikë dhe vendimmarrje;
- Përmirësimi i të drejtave të grave në zona rurale.

Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri - RrFGSh është një organizatë jo-fitimprurëse, e krijuar në vitin 2009, që punon në fushën e të drejtave të grave dhe vajzave. Qëllimi kryesor i këtij rrjeti është fuqizimi social, ekonomik, kulturor dhe politik i gruas shqiptare. Rrjeti përbëhet nga 10 organizata të cilat shtrihen në të gjithë territorin e Shqipërisë, nga veriu në jug:

- Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë
- Forumi i Gruas Elbasan
- Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, Vlorë
- Shoqata e Grave me Probleme Sociale
- Shoqata Unë Gruaja, Pogradec
- Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Tiranë
- Shoqata Agritra Vizion, Peshkopi
- Shoqata Gruaja tek Gruaja, Shkodër
- Shoqata Jona, Sarandë
- Qendra për Nisma Ligjore e Qytetare, Tiranë

Për bashkinë e Shkodrës raporti u hartua me ndihmën e eksperteve Atila Uligaj dhe Besara Podgorica të Shoqatës “Gruaja tek Gruaja”, Shkodër. Ndërsa monitorimi i mbledhjeve të mekanizmit të rreferimit u krye nga dy eksperte të pavarura Juleda Hebovija dhe Romina Dedi.

Shoqata “Gruaja tek Gruaja” është një organizatë jofitimprurëse, jo politike dhe jo fetare që është e regjistruar sipas ligjit shqiptar, si shoqatë, në vitin 2002. Organizata “Gruaja tek Gruaja”, ndër vite, ka kontribuar efektivisht për barazinë gjinore në Qarkun e Shkodrës. Organizata “Gruaja tek Gruaja” punon në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, fokusuar tek të drejtat e grave dhe të vajzave. Aktivitetet e organizatës “Gruaja tek Gruaja” janë të fokusuara në përmirësimin e statusit social, ekonomik dhe politik të grave duke ofruar shërbime këshillimi, shërbime juridike, strehim emergjent, rritje të ndërgjegjësimit publik, trajnime, mbledhje dhe ndarje informacioni,

inkurajimin e grave për të marrë pjesë në mënyrë aktive në vendimmarrje, monitorimin e vendimeve të qeverisjes vendore, parë nga prespektiva gjinore, si dhe drejtimin e fushatave avokuese dhe lobuese për barazinë gjinore në nivel lokal dhe qendror. Shoqata ka zgjeruar gamën e aktiviteteve të saj duke shtrirë fokusin në punën për edukimin gjinor të burrave duke i parë këto si një aspekt shumë të rëndësishëm në përmirësimin dhe rritjen e barazisë gjinore. Aktualisht shoqata ka tre qendra kryesore, Qendrën e shërbimeve për gra, vajza dhe fëmijë, Strehëzën e emergjencës për viktimat e dhunës në familje dhe Zyrën për Djem dhe Burra për trajtim psikologjik të dhunuesve.

Përse monitorim i SKBGJ-së nga OSHC-të?

Përgjegjshmëria në qeverisje është një element i rëndësishëm që përcakton marëdhëniet midis atyre që ushtrojnë fuqinë e pushtetit dhe atyre në emër të të cilëve ushtrohet kjo fuqi. Në sistemet demokratike, fuqizimi i sistemeve të transparencës dhe përgjegjshmërisë është prioritet i vazhdueshëm, që sigurohet përmes mekanizmave të ndërtuar, që përmirësohen vazhdimisht e që garantojnë pjesëmarrjen aktive në vendimmarrjen publike të shoqërisë civile, OShC-ve apo vetë përfaqësuesve të komuniteteve lokale. Këto mekanizma forcojnë proceset demokratike, sigurojnë zhvillim efektiv përmes dhënies së shërbimeve efektive, lehtësojnë procesin e mirëqeverisjes dhe fuqizojnë grupet më vulnerabël të komuniteteve, siç janë vajzat e gratë viktimat të dhunës në familje.

Ndërkohë që ligjet dhe strategjitë kombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e vajzave e grave dhe dhunën në familje/ me bazë gjinore janë hartuar me kontributin e vyer e të pakursyer të OShC-ve të grave, deri tashmë kjo rutinë nuk është shoqëruar me procese monitoruese e vlerësuese nga vetë OShC-të. Organizatat e grave në Shqipëri kanë të gjitha kapacitetet e nevojshme për të monitoruar dhe vlerësuar strategjitë dhe planet e veprimit në fushën që ato punojnë çdo ditë. Mbi të gjitha, ato për shumë vite kanë luajtur një rol vendimtar në adresimin e dhunës ndaj grave nëpërmjet ofrimit të shërbimeve, rritjes së ndërgjegjësimit, ngritjes së kapaciteteve, lobimit dhe avokimit, duke u bërë kështu aktorë kyç në nivel vendor e kombëtar.

Organizatat e SHC janë shumë të interesuara që të monitorojnë strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit, në mënyrë që të ketë një të kuptuar më të mirë të asaj që qeveria po bën në këtë drejtim. Qëllimi përfundimtar është që të zbatojmë një proces monitorimi të paanshëm që do të sigurojë një zbatim më të mirë të hapave të ardhshëm që do ndërmerren për reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe avancimin e barazisë gjinore në shoqëri. Vlen të theksohet se MSHPS, e ka mirëpritur këtë nismë dhe ka theksuar se ky monitorim nga shoqëria civile do të shërbejë për të informuar edhe procesin e monitorimit të brendshëm të SKBGJ 2016-2020 nga institucionet përgjegjëse.

Metodologjia

Për të kryer monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2016-2020 dhe Planit të Veprimit u ndoq një qasje e dyfishtë metodologjike në mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore. Dy monitoruese u përzgjedhën për çdo bashki të targetuar të ngarkuara për të ndjekur punën e bashkisë përkatëse dhe mbledhjen e të dhënave për periudhën Janar – Dhjetor 2017 dhe fillim vitin 2018.

Procesi i mbledhjes së të dhënave është kryer si më poshtë vijon:

1. Mbledhja e të dhënave përmes takimeve informuese me zyrtarë lokal publik. Faza e parë ishte kontakti me kryetarët e bashkive të targetuara për njoftimin e tyre mbi iniciativën e monitorimit. Më pas monitorueset kontaktuan përmes një formati të njësuar koordinatorin vendor të dhunës pranë bashkisë dhe kurdo ishte e mundur drejtorinë e shërbimeve sociale, drejtorinë e shëndetit, organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në territorin e bashkisë, zyrtarët e gjykatave të rrethit, komunitetet fetare, mediat, organizatat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë të përfshirë në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Qëllimi i këtyre takimeve ishte vendosja e kontaktit që më pas u ndoq me kërkesa për informacion, të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera mbi punën e kryer nga bashkia dhe institucione të tjera për adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ për eliminimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Monitorueset gjithashtu kanë ndjekur takimet e zhvilluara në kuadër të mekanizmit të referimit në bashki dhe kanë raportuar mbi përmbajtjen e tyre dhe vendimet e marra.
2. Mbledhja e të dhënave përmes burimeve zyrtare e statistikore. Përmes të drejtës për informim monitorueset kanë kërkuar të gjithë dokumentet mbështetëse të punës së bashkisë në kuadër të luftës kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Specifikisht: Janë mbledhur minutat mbi takimet e mekanizmit të referimit për çdo bashki, që kanë plotësuar informacionet e ndara me monitorueset përmes intervistave.
 - Janë marrë të dhëna statistikore mbi prevalencën e dhunës në familje nga gjykatat, shërbimi i provës, bashkia, policia, shërbimi social dhe INSTAT.
 - Është analizuar buxheti vjetor i bashkisë për të identifikuar burimet financiare të alokuara për zbatimin e SKBGJ në luftën kundër dhunës në familje.
 - Janë mbledhur materiale mbështetëse për aktivitetet ndërgjegjësuere të zhvilluara nga ana e bashkisë për përmbushjen e objektivit 3.1.

Raporti i monitorimit ndjek strukturën e objektivave specifike të SKBGJ sa i përket dhunës me bazë gjinore si edhe aktivitetet specifike të planit të veprimit. Për këtë është hartuar një skedë monitoruese e cila është plotësuar në vijimësi nga monitorueset përmes informacionit të akumuluar përgjatë periudhës monitoruese.

Bazuar tek skeda monitoruese është bërë vlerësim i përmbushjes së angazhimeve të bashkive të targetuara nën objektivin e tretë të SKBGJ duke identifikuar nga njëra anë praktikatat pozitive prej të cilave mund të përfitojnë edhe bashki të tjera dhe nga ana tjetër sfidat dhe mangësitë me të cilat përballen bashkitë, për të identifikuar mundësitë për përmirësim në periudhën e mbetur të planit të veprimit të SKBGJ.

Të dhëna të përgjithshme

Shkodra kufizohet në veri me Bashkinë e Malësisë së Madhe, në perëndim me Malin e Zi, në lindje me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Vau i Dejës dhe një pjesë e saj me Bashkinë Lezhë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Shkodrës. Bashkia e re e Shkodrës kanë përbërjen e saj 11 njësi administrative, të cilat janë: Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postrinë, Pult, Rrethina, Shalë, Shosh dhe Velipojë. Ajo ka nën administrimin e saj një qytet dhe 93 fshatra.¹

Tabela 1: Profili i Bashkisë Shkodër


Bashkia	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative	Fshatrat në përbërje
Shkodër	Shkodër	Bashkia Shkodër	Qyteti Shkodër
		Ana e Malit	Fshatrat: Oblikë, Babot, Muriqan, Shtuf, Dramosh, Oblikë e siperme, Obot, Vallas, Velinaj, Vidhgar
		Bërdicë	Fshatrat: Bërdice e Madhe, Bërdice e mesme, Bërdice e siperme, Trush, Beltoje, Mali Hebahj
		Dajç	Fshatrat: Dajç, Samrisht i Ri, Samrisht i Siperme, Belaj, Mali i Gjymtit, Pentar, Rrushkull, Mushan, Darragjat, Suka-Dajç, Shirq
		Guri i Zi	Fshatrat: Guri i Zi, Juban, Ganjollë, Kuç, Rrencë, Vukatanë, Gajtan, Rragam, Sheldi, Mazrek, Shpor
		Postrinë	Fshatrat: Mes, Dragoç, Boks, Kullaj, Myselim, Drisht, Ura e shtrenjtë, Domen, Shakotë, Prekal, Vilëz
		Pult	Fshatrat: Pog, Kir, Gjuraj, Plan, Khan, Bruçaj, Mgull
		Rrethina	Fshatrat: Dobraq, Grudë e Re, Shtoj i Ri, Guci e Re, Shtoj i vjeter, Zues, Golem, Hot i Ri, Bleran, Bardhaj

¹ <http://zgjedhje2015.reporter.al/profili-i-bashkise-shkoder/>

	Shalë	Fshatrat: Breg-Lumi, Abat, Nicaj-Shale, Lekaj, Vuksanaj, Pecaj, Theth, Nderlysaj, Gimaj, Nënnavriq, Lotaj
	Shosh	Fshatrat: Ndrejaj, Nikaj-Shosh, Palaj, Pepsuj, Brashtë
	Velipojë	Fshatrat: Velipojë, Pulaj, Luarzë, Baks-Rrjoll, Gomsiqe, Baks i ri, Pulaj, Reç i Ri, Ças, Mali Kolaj

Burimi: STAR 2. Raporti i Vetqeverisjes Vendore, Bashkia Shkodër

Figure 1. Harta Administrative e Bashkisë Shkodër



Burimi: STAR 2. Raporti i Vetqeverisjes Vendore, Bashkia Shkodër

Numri më i madh i familjeve është përqendruar në njësinë administrative Bashkia Shkodër me 37,039 familje, ndjekur nga njësia administrative Rrethinat me 7,100 familje, ndërsa numrin më të vogël e ka njësia administrative Pult me 931 familje.

Tabela 2: Të dhëna demografike mbi popullsinë e Shkodrës

Nr	Njesia Administrative	Nr.banorëve	Nr.familje
1	Bashkia Shkoder	114,085	37,039

2	Ana e Malit	5,968	1,653
3	Berdicë	9,655	2,638
4	Dajç	8,998	2,260
5	Guri i Zi	11,838	3,376
6	Postribë	11,730	3,078
7	Pult	3,249	931
8	Rethina	23,923	7,100
9	Shalë	5,934	1,972
10	Shosh		
11	Velipojë	9,574	2,624
Popullsia Totale		204,954	62,671

Burimi: Drejtoria e Gjendjes Civile, Bashkia Shkoder

Asistenca Sociale

3669 familje janë trajtuar me ndihmë ekonomike për vitin 2017 ose 12565 frymë. Pagesa mujore e ndihmës ekonomike për Bashkinë Shkodër ishte 14.832.165 lekë në muaj ose mesatarisht për një familje rreth 4042 lekë në muaj.

Ndërkohë përsa i përket pagesës së paaftësisë dhe shtesave të kempit për invalidët e punës në Bashkinë Shkodër janë trajtuar mesatarisht 6567 persona në muaj si dhe 908 kujdestare të personave me P.A.K me një fond që arrin në 62734 lekë në muaj. Pjesa më e madhe e pagesave për paaftësinë e invalidët e punës janë në Njësinë administrative të Shkodrës prej 4734 persona dhe në njësinë administrative Rrethina në një numër prej 885 persona.

Institucionet Arsimore

Në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër kemi gjithsej 59 kopshte me 1674 fëmijë të regjistruar dhe me 122 edukator/e të punësuar. Numrin më të madh të këtyre institucioneve arsimore e mbajnë njësitë administrative Bashkia Shkodër (24 kopshte) dhe Rrethina (9 kopshte). Mesatarja fëmijë/edukator në të gjithë Bashkinë Shkodër është 14/1. Ndërkohë që në njësitë administrative Pult, Shalë dhe Shosh nuk ka asnjë kopësht fëmijësh.

Numri total i shkollave 9-vjeçare në Bashkinë e Shkodrës është 98 të tilla me 40,059 nxënës të regjistruar dhe 2169 mësues/e të punësuar. Numrin më të madh të shkollave 9-vjeçare e mban njësia administrative Bashkia Shkodër me 33 të tilla dhe me 29,013 nxënës të regjistruar, ndjekur nga njësia administrative Postribë me 10 shkolla 9_vjeçare ku mësojnë 1,606 nxënës. Mesatarja e nxënësve/mësues në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër është 18.4/1.

Ndërkohë përse i përket shkollave të mesme, përveç njësive administrative Pult, Rrethina dhe Shosh njësitë e tjetra administrative kanë nga 1 shkollë të mesme ku përjashtim bën Berdica që ka dy të tilla dhe Bashkia Shkodër me 14 shkolla të mesme. Numri total i shkollave të mesme është 22 me 4306 nxënës të regjistruar ndërkohë që bashkia nuk ka ofruar të dhëna në lidhje me numrin e mësuesve. Shkodra ka një Universitet, atë të emërtuar “Luigj Gurakuqi”.

Strukturat Shëndetësore

Të gjitha njësitë administrative në Bashkinë e Shkodrës janë të pajisura me qendra shëndetësore, ku numrin më të madh të këtyre institucioneve të shëndetit e mban njësia administrative Shkodër me 25 të tilla ndjekur nga Postriba me 11 dhe gjithsej në shkallë bashkie kemi 74 qendra shëndetësore. Numri i ambulancave është më i ulët, gjithsej 27 ku bie në sy se qyteti i Shkodrës nuk ka asnjë të tillë. Në të gjitha qendrat shëndetësore në Bashkinë Shkodër janë të punësuar 490 mjekë dhe infermierë.

Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2017. Raporti do të pasurohet më tej me gjetjet raportimeve per vitet 2018 dhe 2019.

Gjetjet kryesore

Gjetjet kryesore të monitorimit të implementimit të Strategjisë Kombëtare për Barazi Gjinore në bashkinë e Shkodrës janë si më poshtë:

- Gjatë vitit 2017, mekanizmi vendor për rastet e dhunës në familje² ka kryer katër mbledhje e Grupit Teknik Ndërdisciplinar (GTN) dhe një mbledhje e Komitetit Drejtues (KD).

² “Mekanizmat vendorë për rastet e dhunës në familje”. Sipas VKM Nr. 334, datë 17. 2. 2011 “Për mekanizmin e Bashkërendimit të Punës për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe Mënyrën e Procedimit të tij”, mekanizmi i bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në familje përbëhet nga: a) Komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje; b) Ekipet teknike ndërdisciplinore; c) Koordinatorët vendorë për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare. Komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, funksionojnë pranë çdo bashkie. Komitetet drejtuese kryesohen nga Kryetari i Bashkisë dhe në përbërje kanë: a) Përfaqësuesin e strukturës së policisë; b) Përfaqësuesin e gjykatës së rrethit gjyqësor; c) Përfaqësuesin e prokurorisë së rrethit; ç) Përfaqësuesin e drejtorisë arsimore; d) Përfaqësuesin e Drejtorisë së Shëndetit Publik; dh) Drejtuesin e strukturës për shërbimet sociale pranë bashkisë; e) Përfaqësuesin e strukturës për shërbimet sociale në komunë; ë) Përfaqësuesin e zyrës së përmbarrimit; f) Përfaqësuesin e prefekturës; g) Kryetarët e komunave që janë në territorin administrativ që ka për qendër atë bashki; gj) Përfaqësuesin e zyrës përkatëse të punësimit; h) Drejtuesit e organizatave jofitimprurëse që në veprimtarinë e tyre merren me çështje të dhunës në familje; i) Drejtuesit e qendrave/strehëzave të ngritura për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në atë njësi të qeverisjes vendore, ose në qarkun në juridiksionin e të cilit këto njësi janë; j) Përfaqësues të institucioneve fetare, që mund të ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare; k) Drejtuesin e Dhomës së Avokatisë së rrethit.

Sidoqoftë nuk ka koordinim për t'iu përgjigjur rasteve të dhunës në familje shpejt dhe duke trajtuar të gjithë problematikën.

- Gjatë mbledhjeve nuk ka pjesëmarrje të plotë të të gjithë aktorëve të mekanizmit të referimit. Veçanërisht mungojnë institucionet gjyqësore e të përmbartimit, të cilat më së shumti nuk marrin pjesë në takime dhe nuk kanë koordinim me institucionet e tjera, sidomos bashkinë, sa i përket rolit të tyre në luftën kundër dhunës me bazë gjinore.
- Bashkia Shkodër dallohet për risinë e hapjes së qendrave komunitare “Për Familjen” në çdo njësi administrative të zonës urbane të Bashkisë së Shkodrës dhe gjithashtu në njësitë administrative që i takojnë zonave rurale si në Dajç, Gur i Zi, Velipojë, Shalë dhe Rrethina. E rëndësishme është që Bashkia Shkodër ka synim shtrirjen e shërbimeve sociale komunitare në të gjithë territorin e Bashkisë së Shkodrës, dhe ky është një model pozitiv që mund të promovohet e ndiqet edhe nga bashki të tjera të vendit. Pranë këtyre qendrave, ofrohen shërbime për familjet në vështirësi socio-ekonomike, vulnerabël ndaj fenomenit të dhunës në marrëdhëniet familjare. Përmes këtyre qendrave komunitare janë trajtuar dhe mbështetur viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, duke ofruar shërbime sipas nevojave specifike të secilit rast.
- Bashkia e Shkodrës duhet të jetë më shumë e angazhuar në rritjen e ndërgjegjësimit të popullsisë për të mos pranuar dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje. Organizatat lokale të shoqërisë civile luajnë një rol mjaft të rëndësishëm, por sidoqoftë bashkia duhet të parashikojë fonde të posacme për ndërgjegjësimin e popullsisë kundër dhunës në familje.
- Institucionet ligjore si Përmbartimi, Prokuroria dhe Gjykata janë kryesisht ato më pak të angazhuara dhe që mungojnë gjithnjë në mbledhjet e grupit teknik.
- Statistikat e mbledhura nga Sektori i Statistikave pranë Drejtorisë Vendore të Policisë nuk shpërndahen në mënyrë periodike midis aktorëve të mekanizmit të referimit, vetëm në rastet kur kërkohet nga koordinatori vendor.
- Në përmbyllje të çdo viti kalendarik, përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Shkodër, marrin pjesë në analizën vjetore që organizon Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër, ku një vend të veçantë në analizë zënë edhe përqindjet e rasteve të të mbijetuarave të dhunës në familje të referuara pranë bashkisë Shkodër, nëpërmjet vendimeve të Gjykatës.
- Nuk ka fakte të informacioneve të shpërndara me të gjithë aktorët e GTN-së për raste apo çështje të caktuara përmes e-mailit.
- Bashkia Shkodër ka bashkëpunim të mirë me shërbimin e provës e cila nuk u gjet në asnjë bashki bashki tjetër në proces monitorimi. Ky është model pozitiv që mund të shërbejë si praktikë e mirë edhe për bashki të tjera të cilat raportojnë se nuk kanë kontakte dhe bashkëpunim me shërbimin e provës.
- Referimi i rasteve të dhunuesve nga shërbimi i provës për rehabilitim pranë Zyrës për Djem dhe Burra të organizatës “Gruaja te Gruaja”. është gjithashtu një model pozitiv që duhet nxitur edhe në bashki të tjera të vendit ku shërbimet rehabilituese nuk janë të pranishme.
- Organizatat e shoqërisë civile në bashkinë e Shkodrës luajnë një rol të rëndësishëm e pozitiv veçanërisht në funksionimin e mekanizmit të referimit si edhe ofrimin e shërbimeve si ndaj viktimave të dhunës në familje ashtu edhe ndaj personave të dënuar për dhunë në familje dhe dhunë me bazë gjinore.
- Bashkia Shkodër ka krijuar kushtet për një strehëz të shërbimit emergjent për 72 orë në rastet kundër dhunës në familje e cila menaxhohet përmes organizatës “Gruaja te Gruaja”. Mbështetja që ofron Bashkia Shkodër për strehëzën e emergjencës për të mbijetuarat e

dhunës me bazë gjinore është gjithashtu model për t'u ndjekur edhe nga bashki të tjera të cilat ende nuk e ofrojnë këtë shërbim. Megjithatë, monitorimi tregon se kapacitetet e strehëzës janë të kufizuara e nevojiten më tepër burime financiare e njerëzore që strehza të funksionojë sic duhet dhe të jetë e qëndrueshme.

- Nga monitorimi rezulton se është mjaft e rëndësishme të nxitet nga GTN, ofrimi i shërbimeve të tjera përveç atyre ekzistuese, ku më specifiku identifikohet ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës seksuale, për të cilat nuk ka asnjë shërbim të specializuar apo shërbimi ligjor e psikologjik falas.
- Pavarësisht ofrimit të shërbimeve të emergjencës, nuk ofrohen shërbime të strehimit afatgjatë për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, që është sfidë me të cilat përballen shumë bashki në vend, sepse Strehëza Kombëtare për Viktimat e Dhunës në Familje ka kapacitet të limituar.
- Ashtu si të gjitha bashkitë duhet të paktën një herë në vit trajnim i vazhdueshëm i stafit dhe i GTN-së, për dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore. Përgjatë vitit 2017 rezulton se nuk janë kryer trajnime me këtë tematikë për stafin përgjegjës kundër dhunës në familje pranë bashkisë së Shkodrës.

Të dhëna statistikore

Sipas të dhënave të Institutit të Statistikave, për vitin 2017, 4.8% e rasteve të dhunës në familje raportuar në territorin e Shqipërisë gjenden në qarkun e Shkodrës, duke u renditur kështu diku në mes të 12 qarqeve të vendit. Megjithatë, duhet theksuar se norma e grave që denoncojnë dhunën në Shkodër është tejet e ulët, me 15 raportime për 10,000 banorë, nën mesataren kombëtare prej 22.7 raportimesh. Kjo sjell nevojën e adresimit të ndërgjegjësimit të popullsisë për raportimin e rasteve të dhunës pasi ende mund të përbëjë tabu.

Të dhënat statistikore vjetore për Gjykatën e Shkodrës nuk përmbajnë të dhëna mbi veprën penale të dhunës në familje sikundër parashikohet në nenin 130 të Kodit Penal.³ Por këto të dhëna vijnë nga Drejtoria e Përgjithëshme e Policisë së Shtetit.

Drejtoria vendore e Policisë Qarku Shkodër ka në përbërjen e saj 4 komisariate: Komisarati Shkodër, Malësi e Madhe, Pukë, e Vau i Dejës. Të gjitha të dhënat mbledhen e përpunohen në Drejtorinë vendore të Policisë së qarkut Shkodër. Gjatë vitit 2017 për Bashkinë Shkodër janë evidentuar gjithsej 128 raste të raportuara të dhunës në familje. Nga këto janë proceduar penalisht 48 persona sipas veprës penale Neni 130/a prej të cilëve janë arrestuar 31, ndërsa 15 ndiqen në gjendje të lirë. 2 autorë janë të shpallur në kërkim. Gjatë vitit 2017 janë lëshuar 71 kërkesë padi për lëshimin e Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes. 2 personat në kërkim janë kapur brenda muajit dhjetor 2017 dhe janë arrestuar.

³ Për më tepër shiko: <http://WWW.gjykata.gov.al/rrethi-shkod%C3%ABr/gjykata-e-rrethit-shkod%C3%ABr/statistika/c%C3%ABshtjet-penale/>

Tabela 3. Raportimet e dhunës me bazë gjinore në stacionet e policisë së Bashkisë Shkodër

Rastet e dhunës në familje	Bashkia Shkoder
Raste te evidentuara	128
Raste me vrasje	2
Raste me viktima	2
Kërkesë padi për urdhër mbrojtje	71
Shkelje e UM	2
Vepra Penale- Neni 130/a	48
Autorë të arrestuar	31
Autorë të ndaluar	2
Autorë të shpallur në kërkim	2
Autorë në gjendje të lirë	15
Autorë të vetvlarë	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së shtetit

Rezultatet e Monitorimit – Viti 2017

Objektivi 3.1: Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Aktivitetet ndërgjegjësuese për mos pranimin e mos tolerimin e ushtrimit të dhunës me bazë gjinore në bashkinë e Shkodrës janë zhvilluar në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit, sikundër edhe në bashki të tjera të vendit. Në këtë kuadër, përgjatë vitit 2017 janë zhvilluar aktivitete të ndryshme sensibilizuese me anëtarët e mekanizmit të referimit, që konsistojnë në takime me komunitetin në Qendrën Komunitare ‘Për Familjen’, një për secilën nga 6 qendrat komunitare si edhe aktivitete ndërgjegjësuese në rrugë, aktivitete në shkolla dhe qendra shëndetësore, aktivitetete me studentët e universitetit, të zhvilluara në bashkëpunim me organizatën ‘Gruaja tek Gruaja dhe Zyren për Djem dhe Burra.

Fushata gjatë 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës në familje u drejtua nën moton “Asnjëri të mos ngelet pas – fund dhunës ndaj grave dhe vajzave” duke i bërë thirrje të gjithëve të bashkohen për t’i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave. Ditët e 16-të të aktivizmit përbëheshin nga lloje të ndryshme të aktiviteteve të ndërgjegjësimi, duke theksuar nevojën për të ndryshuar ligjet dhe politikat dhe për të gjetur disa mjete të fuqishme për të ndëshkuar dhunuesit, si dhe për të ndryshuar qëndrimet dhe sjelljet që nxisin dhunën ndaj grave dhe vajzave. Fushata u përqendrua kryesisht në veprime ndërgjegjësimi si aktivitetet dhe shfaqjet në rrugë kryesisht duke angazhuar të rinjtë, dhe duke sjellë në vëmendje çështjen e dhunës në familje, rëndësinë e familjes së shëndetshme, pasojat e abuzimit të fëmijëve, dhunën seksuale dhe llojet e tjera të dhunës, kryesisht më pak të njohur dhe denoncuar deri më tani, duke u fokusuar në aktivitetet e komunitetit dhe politikat publike (në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar) që i japin përparësi parandalimit. Përveç kësaj, janë realizuar shumë

diskutime të hapura me grupe të ndryshme të synuara, duke diskutuar rreth temave të filmit mbi barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore, duke bërë gjithashtu sportin si pjesë të zgjidhjes së zvogëlimit të dhunës. Ndryshe nga vitet e kaluara u realizua një eksperiment social në rrugë, si një skenë dhune në një vend publik ku u krijuan kamera të fshehura që dokumentonin reagimet e njerëzve që kalonin.

Në bashkëpunim me zyrën e dhunës pranë policisë e qarkut Shkodër, u organizuan këndet e informimit mbi shërbimet e policisë dhe struktureve të dhunës në familje, dhe funksionimin e mekanizmit të referimit. Këto aktivitete u mbajtën në shkollën e mesme “28 Nëntori”, “Shejnaze Juka” dhe “Oso Kuka”.

Fushata përfshiu rreth 1700 persona direkt, aktivitetet u transmetuan në mediat lokale si dhe përmes kanaleve në internet dhe patën një ndikim të fortë në rritjen e rasteve të denoncuar pranë shërbimeve të ndryshme.. Informacionet rreth aktiviteteve të fushatës janë shpërndarë nëpërmjet mediave sociale si FB, faqja e internetit, blogjet, instagram, si dhe mediat lokale dhe kombëtare. Kishte mbi 900 klikime në kanalet e medias sociale që tregonin interes për aktivitetet e zhvilluara. Përveç kësaj, ka pasur artikuj online dhe postime blogesh për të informuar aktorët dhe publikun për veprimet dhe aktivitetet e realizuara gjatë asaj kohe.

Këtë vit një risi e fushatës ka qënë edhe ndriçimi i godinës së Bashkisë me ngjyrën portokalli për sensibilizimin kundër dhunës me bazë gjinore, si dhe janë printuar 1000 materiale sensibilizuese ku shpenzimet për këto aktivitete në buxhetin e Bashkisë Shkodër janë planifikuar 300.000 lekë.

Bashkia e Shkodrës ka krijuar dhe vënë në funksion Qendrat Komunitare “Për Familjen”; nga një për çdo lagje të qytetit dhe gjithashtu në njësitë administrative në Dajç, Gur i Zi, Rrethina, Velipojë, Postribë dhe Shalë (Theth). Aktualisht janë të krijuara 11 qendra. Pranë këtyre qendrave, ofrohen shërbime për familjet në vështirësi socio-ekonomike, vulnerabël ndaj fenomenit të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe gjithashtu janë trajtuar dhe mbështetur viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, duke ofruar shërbime sipas nevojave specifike të secilit rast. Hapja e këtyre qendrave, ofrimi i shërbimeve pranë tyre dhe koordinimi me institucione të tjera përbën një model pozitiv në Bashkinë e Shkodrës që mund të shërbejë edhe si shembull për bashkitë e tjera të vendit. Qendrat Komunitare janë një komponent i rëndësishëm i sistemit të ofrimit të shërbimeve me bazë komunitare duke ndikuar në përmirësimin e shërbimeve të ofruara në komunitet dhe duke ndikuar në parandalimin e fenomeneve sociale si: abuzimi, neglizhimi, dhuna, trafikimi, etj.

Qendra Komunitare “Për Familjen” është një strukturë që ofron shërbime sociale ditore në mbështetje të grupeve në nevojë dhe me qëllim përmirësimin e mirëqenies sociale, fizike, emocionale dhe edukative.

Shërbimet që ofrohen në këto qendra synojnë përmbushjen e nevojave dhe interesat e përfituesve si dhe referimin apo mbështetjen për të përdorur shërbime të ofruara nga struktura të tjera të specializuara me të cilat Qendra bashkëpunon.

Buxheti i qendrave komunitare “Për familjen” për vitin 2016 ka qënë 6,448,000 lekë ndërsa në vitin 2017 ka qënë 8,658,000 lekë. Vlera e materialeve promovuese për vitin 2017 ka qënë në vlerën 800,000 lekë. Qendra e parë komunitare u hap në dhjetor të vitit 2016, duke vazhduar më pas edhe gjatë vitit 2017 në zonën urbane të Bashkisë së Shkodrës dhe në Njësitë Administrative, me synim shtrirjen e shërbimit komunitar në të gjithë territorin e Bashkisë së Shkodrës.

Nëse i referohemi të dhënave të hedhura në sistem ato bëhen në varësi të rasteve të paraqitura pranë Qendrave Komunitare (Drejtoria e Shërbimeve Sociale) sipas kategorive dhe në varësi të specifikave të rastit kryesisht të dhunës në familje (nëse ka raste të tilla), kërkohet nga Qendra Komunitare ku është paraqitur rasti mbledhja e grupit teknik. Qendrat Komunitare “Për Familjen” bëjnë vlerësimin fillestar të rastit duke identifikuar nevojat dhe kërkojnë pranë koordinitorit vendor mbledhjen e grupit teknik për të referuar këto nevoja. Koordinatori ka për detyrë të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme nëse janë hedhur të gjithë të dhënat për secilën nga qendrat komunitare në sistem, duke bërë evidencë të përmuajshme të rasteve sipas kategorive. Koordinatori raporton 1 herë në vit në ministrinë e linjës lidhur me numrin e rasteve të paraqitura si dhe me numrin e rasteve për të cilat është mbledhur GTN (4 herë gjatë vitit 2017). Po kështu koordinatori vendor raporton lidhur me rastet 1 herë në 3 muaj pranë Komitetit Rajonal Antitrafik. Koordinatori vendor ndan me anëtarët e mekanizmit, pjesë e tryezave teknike ndërsektoriale, detyrat dhe përgjegjësitë për trajtimin e rasteve që diskutohen në mbledhje dhe gjithashtu koordinon punën për zgjidhjen apo plotësimin e nevojave të secilit rast..

Bashkia Shkodër ka bashkëpunim shuëm të mirë me dy donatorët kryesorë në vend që mbështesin mëkënimat kundër dhunës në familje dhe promovojnë barazinë gjinore.

Aktivitetet e realizuara në uadër të ditëve ndërkombëtare kundër dhunës në familje janë renditur si më poshtë:

Tabela 4. Tabela e aktiviteteve të zhvilluar në bashkinë e Shkodrës kundër dhunës në familje

Data	Vendi	Titulli i Aktivitetit	Organizatorët kryesorë
25.11.2017	Sheshi para Bashkisë së Shkodrës	Ceremonia e nderjes së dritave në sloganin “Bëjeni botën portokalli”! JO dhunës ndaj grave dhe vajzave!	Bashkia e Shkodrës, anëtarët e mekanizmit dhe komuniteti.
25.11.2017	Në zyrën e kryetares së Bashkisë	Shfaqja e dramës “Dashuritë e Xhorxh Ëashington”,	Bashkia e Shkodrës, anëtarët e mekanizmit dhe komuniteti.
06.12. 2017	Qendra Komunitare “Për Familjen” nr. 4	Takim informues dhe sensibilizues me komunitetin	Bashkia e Shkodrës
06.12. 2017	Qendra Komunitare “Për Familjen” nr. 5	Takim informues dhe sensibilizues me komunitetin	Bashkia e Shkodrës
07.12. 2017	Qendra Komunitare “Për Familjen” nr. 3	Takim informues dhe sensibilizues me komunitetin	Bashkia e Shkodrës

23.11.2017	Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi,	Ekspozitë Fotografike “Sëedish DADS”/Baballarët Suedez	Gruaja tek Gruaja, SIDA E Bashkia Shkodër
30.11.2017	Zyra për Djem dhe Burra	Ëorkshop me temë: Aksesi në drejtësi dhe roli i juristëve në mbrojtjen dhe informimin e grupeve të pafavorizuara.	Gruaja tek Gruaja
30.11.2017	Gjimnazi “28 Nentori, Oso Kuka, Shejnaze Juka	Takim ndërgjegjësues me nxenes mbi problematikën e dhunës në familje	Gruaja te Gruaja, DVP, DAR Shkoder
4.12.2017	Shkolla 9-vjeçare Bushat	Ëorkshop me nxënës të shkollës 9 vjeçare Bushat mbi parandalimin e dhunës në familje;	Gruaja tek Gruaja
4.12.2017	Drejtoria Vendore e Policisë, Shkodër	Ëorkshop 2 ditor me pjesëmarrjen e Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSH), Shkodër me temë:	Zyra për Djem dhe Burra, Gruaja tek Gruaja
4.12.2017		Rrota e pushtetit dhe kontrollit; drejt një komunikimi jo të dhunshëm.	DVP
4.12.2017		Ngritja e Këndeve Informuese mbi shërbimet policore dhe dhunën në familje.	DAR Shkoder
5.12.2017	Gjimnazi “Oso Kuka ”	Takim ndërgjegjësues mbi problematikën e dhunës në familje	Gruaja tek Gruaja
5.12.2017	Pedonale Shkodër	Street Performance: Mos ki Frike	Gruaja tek Gruaja
5.12.2017	Pedonale Shkodër	Fushatë sensibilizuese në komunitet: Roli i përfshirjes së djemve dhe burrave për barazi gjinore	Zyra për Djem dhe Burra
6.12.2017	Zyra per djem dhe burra	Panel diskutimi me temë: A mund të jetë sporti pjesë e zgjidhjes së reduktimit të dhunës në familje?	Zyra per djem dhe burra
6.12.2017	Pallati i Sportit “Qazim Dervishi”	Fushatë “Sport kundër dhunës”, në ndjekjen e ndeshjes së basketbollit, në Pallatin e Sportit, Shkodër, me pjesëmarrjen e aktivistëve të ZDB	Zyra për Djem dhe Burra
7.12.2017	Biblioteka “Marin Barleti”	Forum studentor me temë: 16 Ditë, 16 Mite	Zyra për Djem dhe Burra dhe Gruaja te Gruaja

8.12.2017	Sheshi “Luigj Gurakuqi”	Street Performance: “Familja ime, Streha ime”	Gruaja tek Gruaja
9.12.2017	Sheshi Pedonale	Street performance: “Familja ime, Streha ime”	Gruaja tek Gruaja, ZDB dhe Oratori Don Bosco, Shkoder
11.12.2017	EU center	Fiml dhe Debat: “I gjithi faji i qiellit”	Ambasada Hollandeze dhe Gruaja tek Gruaja
12.12.2017	Shkolla 28 Nentori	Aktivitet përmbyllës i 16 Ditëve të Aktivizmit.	Zyra për Djem dhe Burra dhe Gruaja te Gruaja

Burimi: Bashkia Shkodër dhe Gruaja te Gruaja

Aktivite të tjera të organizuar në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër ku është trajtuar çështja e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje:

- 21 Shtator - Dita nderkombetare e Paqes. Orë edukative në shkollat e arsimit bazë me fokus përcaktimin e rregullave që zbatimi i tyre do të krijonte një klimë pozitive dhe ndjenjë paqeje në ambjentin shkollë dhe klasë
- 01-31 Tetor 2017 – është ndryshe i shpallur si muaji anti-trafik dhe në kuadër të saj janë parashikuar aktivitete sensibilizuese, orë edukative. Dita nderkombetare kundër Trafikimit. Në moton “STOP Trafikimit” realizohet Ekspozite me punime të fëmijëve në bashkëpunim me Komunitetin Antitrafik pranë Prefekturës Shkodër. Ekspozitë e cila qëndron e hapur gjatë 15 ditëve kalendarike për një publik më të gjërë, dhe përmbillet me marshimin sensibilizues në rrugët kryesore të qytetit.
- 19 Nentor 2017 – Dita kundër dhunës ndaj fëmijëve. Realizohet aktivitet sensibilizues me pankarta slogane dhe fletpalosje duke denuar kështu dhunën ndaj fëmijëve. Aktivitet ky i realizuar në shkollat të arsimit bazë ku aktorë kyç të këtij aktiviteti ishin nxënësit që përcjellnin mesazhe të forta tek mësuesit dhe prindërit të cilët ishin të pranishëm si publik.
- 20 Nentor 2017 – Dita nderkombetare e të drejtave të fëmijëve. Realizohet promovimi i të drejtave të fëmijëve të prezantuara sipas ideve të shkollave përfaqesuese, nëpërmjet marshimit sensibilizues.
- 25 Nentor 2017 – Dita nderkombetare kundër dhunës ndaj grave, fokusi i orëve edukative të realizuara në kuadër të kësaj dite vendoset mbi barazinë me bazë gjinore si dhe të dhunës .

Gjithashtu, bashkinë Shkodër në bashkëpunim me DAR ka realizuar orë edukative sensibilizuese me temë “Dhuna nuk ka vend në shkollat tona”.

UNDP

Bashkia e Shkodrës ka bashkëpunim mjaft të mirë me UNDP, Komisionin Evropian dhe UNWomen. Me mbështetjen e UNWomen, Bashkia e Shkodrës ka nënshkruar në mars të vitit 2017, Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në jetën vendore. Një nismë e tillë është një deklaratë publike që tregon angazhimin e Bashkisë së Shkodrës për të punuar në arritjen e barazisë gjinore në nivel politik, ekonomik, social dhe kulturor. Më tej mbështetur nga UNWomen Bashkia e Shkodrës ka hartuar Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore, si hap i parë i zbatimit në praktikë të Kartës Evropiane për Barazi të burrave dhe grave në jetën vendore.

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, “Për Vetqeverisjen Vendore”, ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare” (i ndryshuar) neni 8, pika 8 e tij; si dhe të VKM nr. 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e proçedimit të tij”, Bashkia e Shkodrës gjatë vitit 2017 me mbështetjen e organizatës “Gruaja tek Gruaja”, ka koordinuar dhe nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për riorganizimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e proçedimit të tij. Kjo marrëveshje është nënshkruar nga të gjitha institucionet publike që veprojnë në territorin e Bashkisë së Shkodrës me rastet e dhunës në familje dhe gjithashtu organizatat e shoqërisë civile që janë aktive dhe veprojnë në territor me këtë target grup.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Mekanizmit të Referimit vihen re të jenë bërë pak hapa pozitivë në funksionimin e kësaj marrëveshje, për shkak se asnjë nga anëtarët e MK nuk ka marrë rolet aktive dhe nuk i përgjigjet detyrimeve dhe përgjegjësi sipas marrëveshjes së nënshkruar. Megjithatë vlen të përmendet se janë shtuar mbledhjet e grupit teknik multidisiplinar që më parë nuk mblidhej, si dhe ka një angazhim më të madh në shkëmbimin e informacionit dhe trajtimin të rasteve, por ende ky mekanizëm nuk funksionon i plotë për shkak se disa nga institucionet, të tilla si: Gjykata, Përmbarimi, Prokuroria, mungojnë gjithnjë në tryezat e grupit teknik ndërdisiplinar.

Gjate vitit 2017 Grupit Teknik Ndërdisiplinar është mbledhur 4 herë. Gjithashtu, grupet teknike ad-hoc janë ngritur në bazë dhe sipas nevojave të rastit, të thirrura nga organizata Gruaja tek Gruaja. Gjatë viti 2017 grupi ad-hoc është mbledhur 5 here, pranë zyrave të organizatës, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqatës “Gruaja te Gruaja”, punonjësit të policisë, përfaqësueses së DAR, Shkodër, Juristës dhe kordinatores se MKR, pranë Bashkisë Shkoder, mjekes pediatre dhe përfaqësueses së Shëndetit Publik, SPZ të zonës sipas rastit. Gjatë këtyre takimeve janë trajtuar problemetikat e 9 rasteve (9 gra dhe me 5 femijë) te akomoduar në strehezën e emergjences

Bashkëpunimi me institucionet në nivel vendor. Bashkia Shkodër ka një bashkëpunim të mirë me të gjithë institucionet vendore përkatësisht 17 institucione pjesë e MKR-së të cilat janë pothuajse gjithnjë të angazhuara në mbledhjet e grupit teknik të tilla si: Drejtoria Vendore e Policisë, Shkodër, Drejtoria Arsimore Rajonale, Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik, Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Shkodër, Drejtoria Rajonale e Punësimit si dhe nga organizatat “Gruaja tek Gruaja” dhe organizata “Hapa të Lehtë”, .

Secili nga specialistët që janë pjesë e MKR, ka luajtur një rol mjaft të rëndësishëm në menaxhimin e rasteve duke marrë masat e nevojshme dhe përgjegjësitë sipas marrëveshjes së nënshkruar me to, për t’i garantuar mbrojtje të mbijetuarave. Referuar edhe informacionit të dërguar pranë Sektorit të Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Tiranë për vitin 2017 Bashkia Shkodër ka organizuar 4

mbledhje të GTN për rastet e dhunës në familje, si dhe ka zhvilluar 1 Mbledhje të Komitetit Drejtues përgjatë gjithë vitit, takim që përkon me nënshkrimin e marrëveshjes së MKR. Në vijim të kësaj Drejtoria e Shërbimeve Sociale pranë bashkisë Shkodër ka referuar 9 raste të të mbijetuarave të dhunës në familje. Krahas kësaj koordinatori thekson se për vitin 2017 janë zbatuar 78 UM/UMM të lëshuara me Vendim Gjykate të Rrethit Gjyqësor Shkodër. Po kështu gjatë intervistës të zhvilluar me koordinatorin theksohet fakti se institucionet ligjore janë kryesisht ato më pak të angazhuara dhe që mungojnë gjithnjë në mbledhjet e grupit teknik, të tilla si Përmbarami, Gjykata, Prokuroria.

Bashkëpunimi me Policinë. Gjatë vitit 2017 ka patur një marrëdhënie të ndërsjellë bashkëpunimi me gjithë institucionet vendore përgjegjëse për zbatimin e ligjit Nr.9669, datë 18.12.2006 për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, ashtu siç edhe me Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër. Ndërkohë, ashtu siç edhe me institucionet e tjera vendore mes Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër dhe Bashkisë Shkodër ka një marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të MKR e nënshkruar mes të gjithë institucioneve, vlen të theksohet se bashkëpunimi me Sektorin e Dhunës në Familje dhe të Miturve është mjaft i mirë dhe efektiv sipas dinamikave të rasteve, ndonëse kjo nuk përfshin referimin direkt të tyre.

Krahas kësaj shefi i Sektorit të Dhunës në Familje dhe të Miturve është gjithnjë i pranishëm dhe i gatshëm në dhënien e ekspertizës në mbledhjet e grupit teknik në varësi të nevojave dhe specifikave të rastit. Për shembull në rastet e kërkesave për informacion statistikor pranë Drejtorisë Vendore të Policisë për numrin e rasteve të denoncimeve për UM/UMM, gjithnjë Drejtoria e Shërbimeve Sociale i drejtohet institucionit me anë të një shkrese zyrtare pasi vetë Sektori i Statistikave pranë Drejtorisë Vendore të Policisë nuk e shpërndan këtë lloj informacioni në mënyrë periodike, por e shpërndan këtë lloj informacioni vetëm në rastet kur i kërkohet nga koordinatori.

Në përmbyllje të çdo viti kalendarik, përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Shkodër, marrin pjesë në analizën vjetore që organizon Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër, ku një vend të veçantë në analizë zënë edhe përqindjet e rasteve të të mbijetuarave të dhunës në familje të referuara pranë bashkisë Shkodër, nëpërmjet vendimeve të Gjykatës.

Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile. Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, ka bashkëpunim të mirë me organizatën “Gruaja tek Gruaja” në bashkëpunim të ngushtë me të cilën ofron strehimin emergjent, këshillimin juridik dhe psikologjik falas si dhe asistencë në gjykatë në çdo seancë. Me mbështetjen e “Gruaja tek Gruaja”, Bashkia Shkodër përgjatë 2017 ka organizuar 4 trajnime 2 ditore me anëtarë të ndryshëm të MKR (SPZ-të e drejtorisë vendore të policisë Shkodër, Mësuesit e shkollave, mjekë dhe infermierë të qendrave shëndetësore, Administratorët e njësive administrative Shkodër). Qëllimi i këtyre trajnimeve ka qënë ngritja e kapaciteteve të strukturave shtetërore për identifikimin, referimin dhe asistencën e viktimave të dhunës në familje në nivel lokal, trajnime të specializuara të cilat janë zhvilluar në bazë të një moduli trajnimi multidisiplinor për identifikimin dhe referimin e rastit në varësi të institucioneve përgjegjëse për implementimin e ligjit të dhunës në familje. Në bashkëpunim me Koordinatorin e MKR dhe institucionet anëtare të mekanizmit u bë e mundur hartimi dhe publikimi i Hartës së shërbimeve për dhunën në familje për Bashkinë Shkodër.

Bashkëpunimi me Gjykatën. Bashkëpunimi me gjykatat nuk ka qenë i mirë, kjo për shkak se ata nuk e kanë prioritarë dhunën në familje, mungojnë në takimet e GTN-së dhe janë të pa interesuar të marrin pjesë në mbledhjet e grupit teknik.

Bashkëpunimi me Zyrën e Punësimit. Në kuadër të bashkërendimit të punës me Zyrën Rajonale të Punësimit, si rrjedhojë e marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar në kuadër të MK, bazuar në nevojat dhe specifikat sipas rastit të referuar, ata janë trajtuar gjithnjë me përparësi nga Drejtoria Rajonale e Punësimit ndonëse tregu i punës është i kufizuar, dhe në shumicën e rasteve nuk përputhet me kërkesat dhe mundësitë e personit të referuar. Drejtoria Rajonale e Punësimit është në komunikim të vazhdueshëm me koordinatoren duke patur përparësi ndërmjetësimin për punësim, si dhe duke shpërndarë herë pas here informacione lidhur me mundësitë që ofrohen në treg për këtë target grup.

Bashkëpunimi me Strehëzën Kombëtare për Viktimat e Dhunës në Familje Tiranë. Së fundmi nuk janë adresuar raste në këtë strehëz, Në të gjithë zonën e Veriut mungon strehimi afatgjatë për viktimat e dhunës.

Bashkëpunimi me Shërbimin Social Rajonal. Bashkëpunimi me Shërbimin Social Rajonal ka qenë i mirë, por një problematikë në shërbimin social e evidentuar është se në rastet emergjente ata kanë kërkuar kohë dhe informacion zyrtar, në një kohë që duhej veprim në emergjencë.

Në vitin 2017, 2% e buxhetit të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale i është dedikuar funksionimit të Mekanizmit të Referimit, ndërkohë që gjatë vitit 2017 Bashkia ka vlerësuar një sërë nevojash për menaxhimin e suksesshëm të rasteve të tilla si rritja e kapaciteteve të shërbimit emergjent, krijimi i mundësive për strehim afatgjatë për viktimat e dhunës si dhe mbështetja financiare nga ministria dhe donatorët e huaj për ekspertizën në koordinimin e trajtimit të rasteve në sistem, duke qenë se bashkia e Shkodrës përbëhet nga 11 njësi administrative, nga të cilat janë 10 zona rurale ku më parë nuk ka funksionuar shërbimi social, e aq më tepër shërbimi për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

Rrjeti i shërbimeve komunitare me nëpërmjet qendrave komunitare “për familjen” ka filluar të krijohet gjatë vitit 2016. Duke qenë se janë në hapat e parë të shtrirjes e konsolidimit të shërbimeve, duke qenë se territori është zgjeruar, ku më parë nuk ka funksionuar shërbimi social, një territor me zona shumë të vështira për akses, në zona malore, me infrastrukturë të vështirë nevojiten mjete të duhura për lëvizjen dhe aksesin.

Strehëza emergjente është e ngritur, por kapaciteti i saj është shumë i vogël, vetëm 2 dhoma me nga 2 shtretër; me shumë rëndësi është rritja e kapaciteteve për shërbimin e strehimit emergjent. Përveç strehëzës, si shërbim i specializuar për strehimit e viktimave të dhunës në familje, është shumë i rëndësishëm krijimi i shërbimeve tjera të specializuara si; shërbimi i asistencës me telefon që mungon, qendrat për trajtimin e krizave për shkak të përdhunimit, abuzimit seksual, shërbimet për raste traumash etj.

Gjithashtu aspekt tjetër shumë i rëndësishëm është ngritja e kapaciteteve për anëtarët e GTN-së për zbatimin e ligjit dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Gjatë vitit 2017 janë zhvilluar

trajnime mbi çështje të përgjithshme të dhunës dhe trafikimit dhe mbrojtjes së fëmijëve, por jo specifike mbi dhunën me bazë gjinore apo barazinë gjinore.

Në vitin 2017 Bashkia e Shkodrës me mbështetjen e “Save the Children” ka bërë të mundur administrimin e të dhënave të rasteve që marrin shërbim pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale Bashkia Shkodër, program në të cilin kanë akses dhe çdo specialist pranë Qendrave Komunitare “Per Familjen”, në mënyrë që të dokumentohet çdo rast që trajtohet pranë këtyre qendrave.

Trajnimet për vitin 2017:

- Gjatë vitit 2017 Drejtoria e Shërbimeve Sociale nuk ka marrë asnjë trajnim sa i takon dhunës në familje apo barazisë gjinore. Sipas koordinorit vendor të vetmet trajnime që janë zhvilluar janë ato me pjesëmarrjen e anëtarëve të MKR, me mbështetjen e organizatës “Gruaja tek Gruaja” si dhe trajnime të cilat kanë qënë të lidhura kryesisht me menaxhimin e rasteve të të miturve në situatë rruge, të mbështetura këto nga Save the Children dhe Terres des Hommes, me pjesëmarrjen e stafëve të qendrave komunitare.
Trajnim me temë: “Kompjuterizimi i të dhënave online dhe përdorimi i database për rastet e familjeve” – ICT në bashkëpunim me Save the Children me pjesëmarrjen e stafëve të Qendrave Komunitare “Për Familjen” dhe stafit të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.
- Trajnim me temë: “Reagimi i koordinuar kundër dhunës me bazë gjinore” me pjesëmarrjen e anëtarëve të MK me qëllim adresimin në mënyrë sa më efektive të viktimave të dhunës në familje.
- Trajnim me temë: “Komunikimi me një dhunues”- mbështetur nga organizata “Gruaja tek Gruaja” dhe Linja e Këshillimit për Grad he Vajza, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financuar nga Iamaneh.
- Trajnim me temë: “Bilanci i përgjithshëm gjinor në institucionet lokale: njohja dhe realizimi i integritet gjinor në politikat publike”- mbështetur nga CIES në bashkëpunim me ASPA.
- Trajnim me temë: “Protokolli I Mbrojtjes së Fëmijëve Nivelet e rrezikut. Vlerësimi fillestar dhe I thelluar”- mbështetur nga Terres des Hommes, me pjesëmarrjen e stafëve të qendrave komunitare “Për Familjen”.

Tabela 5. Numri i mbledhjeve të GTN-së sipas viteve

Viti	Mbledhjet e GTN
2014	2
2015	3
2016	4
2017	4

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, Bashkia e Shkodrës

Tabela 6. Numri i mbledhjeve të KD-së sipas viteve

Viti	Mbledhjet e KD
2014	0
2015	1

2016	1
2017	1

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, Bashkia e Shkodrës

Tabela 7. Koordinatorit vendor kundër dhunës me bazë gjinore

Viti	Koordinatori Vendor kundër DhBGj
2014	Jeta Xhabija
2015	Jeta Xhabija
2016	Jeta Xhabija
2017	Jeta Xhabija

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, Bashkia e Shkodrës

Tabela 8. Përfaqësuesit e GTN-së së bashkisë Shkodër

Institucioni	Specialisti përgjegjës	Telefoni	E-mail
Bashkia Shkodër	Jeta Xhabija	0692676901	sherbimetsociale@bashkiashkoder.gov.al
Gruaja tek Gruaja	Majlinda Angoni	0682079112	gruajatekgruaja@gmail.com
Zyra e Përmbartimit Shkoder	Enderson Memçaj	0664144443	enderson.memcaj@hotmail.com
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër	Arben Zefi	0692060556	arben.e.zefi@me.com
Mjeku Ligjor	Dhori Toshe	0672036350	-
Shërbimi i Provës	Frida Dashi	0673368997	fridadashi36@gmail.com
Prokuroria Shkodër	Anton Martini		
Spitali Rajonal, Shkodër	Dhurata Rrjollli		SpitaliShkoder@shendetesia.gov.al
Drejtoria Arsimore Rajonale, Shkodër	Kadri Ymeri	0673103543	darshkoder@arsimi.gov.al
Drejtoria Rajonale e Punësimit, Shkodër	Rozafa Zmijani	0694081600	roz.zmijani@yahoo.com

Qendra e Formimit Profesional Publik Shtetëror Shkodër	Meri Markici Valbona Tula	0672301424	sekretariadrffpp@gmail.com bona7450@yahoo.com
Dr.Sherbimi Social Shtetëror			
Drejtoria Vendore e Policisë, Shkodër	Vehbi Bushati/Drejtor Dedë Gazulli	0694104022	dedegazulli@hotmail.com
Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik, Shkodër	Astrit Beci	0682050949	DRSHShkoder@shendetesia.gov.al
Zyra për Djem dhe Burra	Endrit Uligaj Fisnik Thorja	0692089072 0697782609	e.uligaj@universal.al fisnikthorja@hotmail.com
Hapa të Lehtë	Denada Shpuza/Kraja		hapatelehte@gmail.com

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara.

Shërbimi për trajtimin e dhunuesve ofrohet pranë Zyrës për Djem dhe Burra (ZDB), degë e organizatës Gruaja tek Gruaja në Shkodër, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet publike dhe OJF-të që operojnë në këtë Bashki. ZDB është pjesë e Mekanizmit të referimit kundër dhunës në familje në Bashkinë e Shkodrës, Bashkinë e Malësisë së Madhe dhe Vau Dejës, duke bashkëpunuar në mënyrë aktive me Gjykatën e rrethir Gjyqësor të Shkodrës, Drejtorinë e Policisë, Shërbimin e Provës, Dhomën e Avokatisë, Shërbimin Social Shtetëror si dhe organizatat e tjera që angazhohen në çështjet e dhunës në familje.

Shërbimi për trajtimin e dhunuesve në Bashkinë Shkodër është ngritur në korrik të vitit 2014. Për ngritjen e këtij shërbimi, është zhvilluar një trajnim 2 – vjeçar, përkatësisht me djem të diplomuar në degët psikologji dhe punë sociale, dhe me eksperiencë pune në fushën e të drejtave të njeriut dhe çështjet gjinore.

Shërbimi për trajtimin e dhunuesve pranë ZDB, përmban komponentët e mëposhtëm:

- Këshillim individual ballë për ballë,
- Këshillim individual në telefon,

Kryesisht, klientët referohen pranë shërbimit nga institucionet partnere: Gjykatat, Policia, Shërbimi i Provës etj. Klientët paraqiten në çdo rast pranë zyrat e qendrës së shërbimit të shoqëruar, vetëm në takimin e parë, nga një punonjës i institucionit referues.

Praktikat e ndërhyrjes bazohen në besimin që dhuna është një sjellje e mësuar dhe burrat që kryejnë akte dhune, e kanë mundësinë dhe aftësinë për të modifikuar dhe ndryshuar sjelljet e tyre të dhunshme. Gjatë procesit të këshillimit fokusi vihet mbi temën e dhunës, mardhënien që klienti ka me dhunën, besimet, bindjet, traditat, modelet, normat e klientit dhe një peshë të madhe zë diskutimi mbi aktet e dhunës së kryer nga klienti dhe pasojat e kësaj dhune tek viktimat e tij.

Këshilluesi e shoqëron klientin e tij drejt kuptimit dhe pranimit të përgjegjesive dhe pasojave të veprimeve të tij të dhunshme dhe gjetjes së motivimit për të ndryshuar sjellje. Shërbimi i këshillimit jepet nga këshillues profesionistë të trajnuar dhe çertifikuar për ofrimin e këtij shërbimi dhe në ambjentet e ZDB-s të konceptuar enkas për këto lloje shërbimi. Një cikël zgjat minimalisht 16 - 24 seanca. Seanca zgjat 50-55 minuta dhe çdo klient ndjek 1 seancë në javë. Shërbimi ofrohet falas për të gjithë klientet. Klientet që marrin këto shërbime duhet të përmbahen kushteve dhe rregullave të caktuara, me të cilat njihen paraprakisht.

Gjatë vitit 2017, pranë ZDB janë referuar 22 burra me të cilët janë realizuar 152 seanca këshillimi në total.

Tabela 9. Tabela e referimeve të dhunuesve

Institucioni referues	# i personave të referuar
Dhoma e Avokatisë	1
Policia	2
Gjykata Shkodër	9
OJF	1
Shërbimi i provës	4
Vullnetar	2
Individë	3
Shkolla	10
Total	22

Burimi: Gruaja tek Gruaja, Shkodër

Nga keto raste, 5 klientë kanë përfunduar ciklin e plotë të trajtimit dhe po ndiqen përmes programit të Folloë Up. Bashkëpunimi i GTGmë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër është rritur gjatë vitit 2017, duke parë rritjen e numrit të vendimeve ku Gjykata urdhëron dhunuesin të marrë pjesë në programe rehabilitimi pranë ZDB. Megjithatë, numri i vendimeve mbetet mjaft i ulët në krahasim me numrin e UMM/UM (197) të lëshuara nga gjykata për të njëjtën periudhë, Janar – Dhjetor 2017. Ky numër i ulët referimi vjen si pasojë e nivelit të ulët ndërgjegjesimit të gjykatësve për nevojën e përfshirjes së dhunuesve në programe rehabilitimi. Në të njëjtën kohë, nga informacioni që marrim nga ZDB kuptojmë që institucionet të cilat plotësojnë kërkesat për Urdhër Mbrojtje për viktimat e dhunës në familje nuk janë të informuar dhe të ndërgjegjësuar mbi shërbimin për rehabilitimin e dhunuesve dhe si rrjedhojë, gjatë plotësimit të kërkesës për UM nuk kërkojnë masën për të urdheruar rehabilitimin e dhunuesve. Në të njëjtën kohë, viktimat nuk kanë asnjë informacion në lidhje me këtë shërbim. Shërbimi i Provës është gjithnjë i pranishëm në mbledhjet e GTN. Koordinatori merr në mënyrë periodike informacion nga Shërbimi i Provës lidhur me numrin e rasteve të dhunuesve të cilët referohen për t'u trajtuar në programe rehabilitimi pranë “Zyrës për Djem dhe Burra”, si dhe krahas kësaj specialisti pranë Shërbimit të Provës është i informuar mbi ecurinë e këtyre rasteve, dhe kohëzgjatjen e shërbimit. Gjatë vitit 2017, Shërbimi i provës ka trajtuar 14 raste të dhunuesve, dhe ka referuar pranë Zyrës për Djem dhe Burra 4 raste për tu përfshirë në programin e rehabilitimit psikologjik.

Funksionimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me shërbimin e provës është për t'u vlerësuar për bashkinë e Shkodrës dhe mund të shërbejë si model pozitiv edhe për bashkitë e tjera ku ky bashkëpunim dhe bashkërendim i punës aktualisht mungon. Një aspekt që mund të përmirësohet

në përmbushjen e objektivit 3.3 është ndryshimi i mënyrës së mbledhjes së të dhënave dhe publikimi i statistikave nga shërbimi i provës. Disagregimi i të dhënave sipas gjinisë dhe llojit të veprës penale do të ndihmonte në analizën më të mirë të situatës dhe identifikimin e personave të dënuar për dhunë me bazë gjinore për ofrimin e shërbimeve për rehabilitimin e tyre.

Bashkëpunimi i policinë është shumë i mirë dhe një pikë e fortë, kryesisht në zbatimin e vendimeve të gjykatës për identifikim dhe afrimin e dhunuesve pranë shërbimit të ZDB.

Tabela 10. Dhunuesit në sistemin gjyqësor Shkodër

Vitet	Nr. i dhunuesve
2014	66
2015	89
2016	120
2017	126

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik

Rekomandime në bazë të monitorimit të punës kundër dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Shkodër

Në bazë të monitorimit të implementimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Shkodrës më poshtë renditen disa rekomandime të cilat kërkojnë masa të menjëherëshme për të rregulluar funksionimin e Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Shkodër dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ, kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje:

- Roli i Koordinatorit Vendor të Dhunës është shumë i rëndësishëm në koordinimin dhe funksionimin e mekanizmit të referimit ndaj është e domosdoshme të rishikohet struktura aktuale e bashkisë për të siguruar burimet e duhura financiare dhe kohore për performimin e detyrave të koordinatorit vendor.
- MKR duhet të mbledhet rregullisht çdo muaj, për shkak të numrit të madh të raportimeve për dhunën në familje si dhe të UM dhe UMM të dhëna nga bashkia.
- Koordinatorin kundër dhunës duhet të krijojë takime dhe të informojë të gjithë anëtarët e MKR-së në rastet kur ata ndërrohen për shkak të detyrës apo tjetër.
- Gjatë mbledhjeve duhet të mbahen minutat dhe të përgatiten skedat e të dhënave për rastet konkrete. Rastet të ndiqen deri në krijimin e bindjes se janë jashtë rrezikut të dhunuesit.
- Të gjitha institucionet pjesë e mekanizmit sipas LDHF duhet të përcaktojnë një përfaqësues të qendrueshëm dhe kompetent, të cilët duhet të marrin pjesë në të gjitha takimet e MKR-së. Të gjithë anëtarët e MKR-së këta duhet të marrin rol aktiv kundër dhunës me bazë gjinore. Në lidhje me Shkodrën institucionet ligjore të tilla si Përmbartimi, Gjykata, Prokuroria, janë kryesisht ato më pak të angazhuara dhe që mungojnë gjithnjë në mbledhjet e grupit teknik,
- Statistikat e mbledhura nga Sektori i Statistikave pranë Drejtorisë Vendore të Policisë duhet të shpërndahen në mënyrë periodike. Bashkëpunimi i mirë ndërmjet bashkisë Shkodër dhe Shërbimit të Provës është model pozitiv që mund të shërbejë si praktikë e mirë edhe për bashki të tjera të cilat raportojnë se nuk kanë kontakte dhe bashkëpunim me shërbimin e provës.

- Referimi i rasteve të dhunuesve nga shërbimi i provës për rehabilitim pranë Zyrës për Djem dhe Burra është gjithashtu një model pozitiv që duhet nxitur edhe në bashki të tjera të vendit ku shërbimet rehabilituese nuk janë të pranishme.
- Organizatat e shoqërisë civile në bashkinë e Shkodrës luajnë një rol të rëndësishëm e pozitiv veçanërisht në ofrimin e shërbimeve si ndaj të mbijetuarave të dhunës në familje por duhet bërë më tepër për trajtimin e personave të dënuar për dhunë në familje dhe dhunë me bazë gjinore.
- Ekzistenca e strehëzës së emergjencës është gjithashtu model për t'u ndjekur edhe nga bashki të tjera të cilat ende nuk e ofrojnë këtë shërbim dhe për të cilin në raporte të tjera monitorimi konsiderohet si mangësi që duhet adresuar. Megjithatë, monitorimi tregon se kapacitetet e strehëzës janë të kufizuara e më tepër burime financiare e njerëzore nevojiten.
- Nga monitorimi rezulton se është e rëndësishme ofrimi i shërbimeve të specializuara për rastet e dhunës seksuale dhe rastet e dhunës me bazë gjinore ndaj grave me aftësi ndryshe. Pavarësisht ofrimit të shërbimeve të emergjencës, duhet të planifikohen dhe financohen shërbime të strehimit afatgjatë dhe shërbime rehabilituese për të mbijetuarat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Në kuadër të krijimit të rrjetit të qendrave komunitare “Për Familjen” dhe shtrirjes së shërbimeve sociale dhe komunitare në të gjithë territorin e bashkisë së Shkodrës, synohet mbulimi me shërbime i të gjithë territorit, duke arritur kështu parandalimin e rasteve të dhunës dhe trajtimin e rasteve të identifikuar.
- Trajnim i vazhdueshëm i stafit për dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore, mbi ndryshimet në legjislacionin shqiptar dhe mënyrat e ofrimit të shërbimeve për trajtimin e rasteve të dhunës në familje apo dhunës me bazë gjinore. është shumë i rëndësishëm.
- Bashkia e Shkodërimit duhet të jetë më aktivisht e angazhuar në rritjen e ndërgjegjësimit të popullsisë për të mos pranuar dhe toleruar dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje. Bashkia e Shkodërimit duhet të alokojë fonde për fletëpalosje dhe materiale të tjera informuese dhe ndërgjegjësues për qytetarët e Shkodërimit. Informacioni brenda këtyre materialeve duhet të hartohet në bashkëpunim me organizata e shoqërisë civile.
- Bashkia e Shkodërimit duhet të ofrojë shërbime mbështetëse për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe për personat e dënuar për dhunë me bazë gjinore. Bashkia Shkodër duhet të ndërtojë një qendër emergjence sa më parë dhe ta mbështesë me mjete financiare dhe burime njerëzore.
- Në përgjithësi, burimet njerëzore, financiare dhe operationale si të aktorëve publikë ashtu edhe jofitimprurës duhen bashkërenduar për të krijuar mekanizma të përbashkët për ofrimin e shërbimeve.
- Koordinatori duhet të krijojë lidhje të vazhdueshme e të qendrueshme me policinë në kuadër të mekanizmit të referimit. Nuk duhet të ketë mungesë komunikimi, koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet këtyre institucioneve për referimin sa më efikas të rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunën në familje. Rritja e komunikimit ndërmjet këtyre dy institucioneve është prioritarë për mirëfunksionimin e mekanizmit të referimit të rasteve të dhunës.
- MKR Shkodër duhet të veprojë si një e tërë për të gjitha rastet e dhunës me bazë gjinore. Roli i çdo institucioni është shumë i rëndësishëm që rasti të marrë të gjithë ndihmën e duhur si viktimat, fëmijët por edhe dhunuesi.
- Në Bashkinë e Shkodërimit duhet të ndërtohet një sistem për trajtimin e dhunuesve në bazë të objektivit 3.3.

Aneke

Aneksi 1- Detyrat e koordinatorit për barazi gjinore dhe kundër dhunës në familje

- Lehtëson bashkëpunimin e organeve të qeverisjes vendore me organet e qeverisjes qendrore për zbatimin dhe monitorimin e legjislacionit dhe politikave shtetërore për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje;
- Mbështet organet e qeverisjes vendore, në pajtim me kompetencat e tyre, që të nxisin dhe krijojnë mundësi të barabarta për gratë dhe burrat duke hartuar politika, duke ndërmarrë masat e përshtatshme dhe veprimet e nevojshme për eliminimin e diskriminimit gjinor dhe arritjen e barazisë gjinore në trajtim dhe mundësi;
- Jep rekomandime për respektimin e parimit të përfaqësimit të barabartë gjinor në organet e qeverisjes vendore veçanërisht gjatë ngritjes së grupeve të punës, komisioneve e delegacioneve;
- Mbështet organet e qeverisjes vendore dhe lehtëson bashkëpunimin e ngushtë të tyre me organizatat jofitimprurëse lokale dhe organizma akademike për arritjen e barazisë gjinore në fusha të ndryshme si dhe për programe në mbrojtje të viktimave të dhunës në territorin që ato mbulojnë;
- Bashkëpunon me strukturat përkatëse në Ministrinë e linjës për çështjet e barazisë gjinore dhe mbështet organet e qeverisjes vendore për: a. mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e statistikave vendore të ndara sipas gjinisë. b. Përgatitjen dhe dhënien e informacioneve dhe raporteve periodike lidhur me politikën, strategjitë, dokumente të tjera politikash, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, sipas planifikimit vjetor të punës së bashkisë. c. Përgatitjen dhe dhënien e informacionit periodik për aktivitetet e kryera nga Bashkia në kuadrin e promovimit të barazisë gjinore dhe statusit të gruas shqiptare si dhe luftën kundër dhunës në familje d. Të dhëna statistikore për nivelin e dhunës në familje, në bashki/njësi administrative (nga Drejtoria e policisë, Drejtoria Arsimore, Drejtoritë e Shërbimeve Sociale).
- Inicion dhe merr pjesë aktive në aktivitetet dhe fushatat ndërgjegjësuëse për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje, të organizuar nga bashkia ose që organizohen në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe shoqërinë civile (takime, ëorkshope, biseda dhe shkrime në media);
- Përgatit informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për pasqyrimin e çështjeve gjinore për ta pasqyruar në ëbsite, buletinet apo mjetet e tjera të informimit të Bashkisë (aty ku ekzistojnë);
- Punon për ndërgjegjësimin e punonjësve dhe drejtuesve të tjerë të bashkisë përsa i takon çështjeve të barazisë gjinore dhe dhunës në familje.

Koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare

Detyrat kryesore

- drejton punën e ekipit teknik ndërdisiplinor, ndërmerr iniciativën dhe organizon takimet e këtij ekipi, si dhe informon për ecurinë e punës së tij komitetin drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje;


- koordinon ekipin teknik ndërdisiplinor sipas përcaktimeve në pjesën I, pika 2 të VKM, për rastet që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, dhe siguron burime ose shërbime reference për individët që kërkojnë strehim, asistencë ligjore falas, këshillim dhe të tjera mbështetje të nevojshme;
- shërben si ndërmjetës me OJF-të, policinë, shërbimet shëndetësore, gjykatat, shërbimet sociale, dhe të tjera institucione/organizata referimi, për të dhënë informacion për t'i lidhur viktimat me shërbimet dhe për të siguruar vazhdimësinë e kujdesit ndaj tyre;
- asiston viktimat në njohjen e të drejtave të tyre dhe në ndjekjen e procedurave të nevojshme për marrjen e një urdhri mbrojtjeje/urdhri të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe për hapat që duhen ndjekur nëse urdhri shkelet;
- shoqëron viktimat e dhunës në gjykatë, polici dhe pranë shërbimeve të tjera;
- harton një listë të organizatave jofitimprurëse e të profesionistëve, të cilët ofrojnë shërbime falas për viktimat e dhunës (psikologjike, këshillim, shërbime mjekësore, juridike falas, strehim etj.) dhe e rifreskon atë vazhdimisht;
- sigurohet që dosjet dhe dokumentacioni rreth klientëve të jetë i saktë, i plotë dhe i përditësuar, si dhe siguron ruajtjen e kopjeve të urdhrave të gjykatës dhe të dokumentacionit të kërkuar;
- përditëson të dhënat për të gjitha rastet e dhunës në familje, të trajtuara nga ekipi teknik ndërdisiplinor, në një bazë elektronike të mbajtjes së të dhënave, si dhe ndan një herë në muaj një informacion të përmbledhur për rastet e trajtuara me gjithë anëtarët e këtij ekipi.
- organizon dhe monitoron takime për menaxhimin e rasteve;
- sigurohet që viktimat të marrin kërkesat për paraqitje në gjykatë, urdhrat e lëshuara ngagjykata për ndjekjen e hapave të duhur në rast shkeljeje të urdhrave të gjykatës, si dhe sigurohet që të kryhen të gjitha llojet e ndërhyrjeve të nevojshme në përputhje me ligjin;
- koordinon organizimin e trajnimeve të ndërmarra nga struktura përgjegjëse për dhunën në familje e Ministrisë, për ekipin teknik ndërdisiplinor dhe personelin tjetër që punon me komunitetin;
- mbështet informimin e anëtarëve të komunitetit, të profesionistëve dhe organizatave jofitimprurëse rreth dhunës në familje dhe shërbimin me materiale ose botime të ndryshme sensibilizuese e ndërgjegjësuere për dhunën;
- harton marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore për realizimin e detyrave në funksion të zbatimit të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, në përputhje me përcaktimet e marrëveshjes së bashkëpunimit tip, bashkëngjitur këtij vendimi, dhe ia propozon ato komitetit drejtues për miratim në parim;
- paraqet raporte mujore, tremujore dhe vjetore përpara komitetit drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, në formë të përmbledhur, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave. Këto raporte përmbajnë informacion për rastet në të cilat është ndërhyrë përprocedurat e ndjekura, masat e ndërmarra dhe problemet e ndeshura, që mund të kërkojnë zgjidhjen nga komiteti drejtues;
- identifikon protokolle ekzistuese në komunitet ose marrëdhënie informale bashkëpunimi që janë të suksesshme;
- propozon në strukturën e shërbimeve sociale pranë njësisë së qeverisjes vendore, pranë së cilës funksionon, krijimin e shërbimeve të nevojshme për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.

Aneksi 2- Detyrat e të gjithë anëtarëve që kanë nëshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit si pjestarë të Mekanizmit të Rreferimit kundërDhuës me Bazë Gjinore

Aneksi 3 – Informcion shtesë

Pas ndarjes së re territoriale Bashkia e Shkodrës e ka pothuajse dyfishuar popullsinë, duke arritur 204,954 banorësh, dhe ka një rritje prej rreth 52 here, të territorit duke u shtrirë në një sipërfaqe prej 872.71 km² dhe ka nën administrimin e saj një qytet dhe 93 fshatra.

Bashkia e Shkodrës kufizohet në veri me Bashkinë e Malësisë së Madhe, në perëndim me Malin e Zi, në lindje me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Vau i Dejës dhe një pjesë e saj me Bashkinë Lezhë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Shkodrës. Bashkia e re e Shkodrës ka në përbërjen e saj 11 njësi administrative, të cilat janë: Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh dhe Velipojë.



Shkodra sot është një nga qytetet në të cilin ndodhen e funksionojnë shumë institucione e qendra sociale në mbështetje të grupeve sociale në nevojë. Përveç qendrave e institucioneve publike dhe private, tradita e njohur bamirëse shkodrane ka krijuar një klimë nxitëse e pozitive për krijimin e shërbimeve të shumta, të reja e alternative nga organizat jofitimprurëse vendase e të huaja, nga institucionet fetare dhe individë. Nevojat e mëdha të shkaktuara nga tranzicioni i tejzgjatur dhe “klima” humanitare e qytetarëve tanë kanë krijuar një rrjet mbështetjeje, shërbimesh e përkujdesi për grupet sociale më në rrezik.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Vendore funksionet e bashkive për shërbimet sociale përfshijnë:

- Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- Ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- Ndërtimi dhe administrimi i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.
- Krijimi në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Bashkia Shkodër ka zhvilluar Politikat Sociale për territorin ku vepron të cilat përfshijnë:

- Mbulimi sa më i plotë i territorit me Shërbime Sociale duke u harmonizuar me nevojat dhe interesat e komunitetit.
- Gjithëpërfshirja, Pjesëmarrja, krijimi i Mundësive të Barabarta dhe Mosdiskriminimi për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, origjinës, minoritetit etj.
- Bashkërendimi dhe harmonizimi i aktiviteteve lokale me strategjitë dhe politikat kombëtare, me instiucionet në varësi të pushtetit qëndror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare.
- Partneriteti i ngushtë ligjor me shoqërinë civile, organizata jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti.
- Me qëllim fuqizimin e Shërbimeve Sociale në Bashkinë e Shkodrës shërbimi i Strehimit është pjesë e Shërbimit Social, duke sjellë harmonizimin dhe bashkërendimin më efikas të shërbimeve sociale në mbështetje të grupeve sociale më në nevojë.
- Përmirësimi i shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përmes aktiviteteve të edukimit e promocionit shëndetësor, parandalimit të sëmundjeve dhe shërbimeve të tjera shëndetësore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetsësor.